

RAPORT I PËRKOHSHËM 13 shtator – 29 shtator 2017

6 tetor 2017

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

- Qeveria u formua me vonesë prej gjashtë muajsh pas zgjedhjeve të fundit të parakohshme parlamentare, që rezultoi me shtyrjen e zgjedhjeve lokale. Në korrik, qeveria paraqiti një plan për trajtimin e problemit me keqpërdorimin e burimeve administrative, presionin mbi nëpunësit publikë, mbulimin jo të balancuar mediatik dhe përmirësimin e transparencës së administratës zgjedhore.
- Korniza ligjore e zgjedhjeve u ndryshua dukshëm në vitin 2016. Me ndryshimet plotësuese në vitin 2017 u ndryshua koha e mbajtjes së zgjedhjeve lokale dhe u autorizua Kuvendi që ta ndryshojë përbërjen e Komisionit shtetëror zgjedhor (KSHZ).
- Mbledhjet e KSHZ-së janë publike; megjithatë, disa vendime deri tani janë marrë në mbledhje të mbyllura dhe vëzhguesit jo çdoherë janë informuar paraprakisht për to. Shumica e Komisioneve zgjedhore komunale (KZK) janë funksionale dhe janë duke u bërë përgatitje për punën e tyre, mirëpo disa kanë raportuar se kanë mungesë të hapësirave dhe të materialeve. Për ta siguruar të drejtën e votës për personat me pengesa, KSHZ-ja i ka shënuar vendvotimet në të cilat ka qasje për karrocet invalidore dhe planifikon që të gjitha vendvotimet t'i furnizojë me shabllon për fletëvotime që është i ndjeshëm në prekje. Fushata për edukimin e votuesve akoma nuk ka filluar.
- Për këto zgjedhje janë regjistruar gjithsej 1,814,644 votues. Verifikimi onlajn dhe personalisht i listave zgjedhore rezultoi me ndryshime të vogla. Si rezultat i kësaj, disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën besim të shtuar në saktësinë e regjistrimit të votuesve, kurse disa të tjerë vazhduan të shprehin shqetësim për këtë.
- KZK-të regjistruan 19 parti dhe koalicione, si dhe 65 grupe votuesish, për gjithsej 258 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 369 lista për këshillat komunalë. Gjashtë për qind e kandidatëve për kryetarë të komunave janë gra dhe 14 për qind e listave për këshillat komunalë kryesohen nga gratë. Kandidatët dhe listat tentojnë të pasqyrojnë përbërjen etnike të komunës përkatëse.
- Periudha e fushatës zgjedhore filloi më 25 shtator. Garuesit deklaruan publikisht se do të sillen në mënyrë joprovokuese gjatë fushatës, ndërsa qeveria premtoi se do ta respektojë parimin e ndarjes së shtetit nga partia. Garuesit në zgjedhje shfrytëzojnë mjete të ndryshme për të arritur deri te votuesit, duke i përfshirë edhe mediat onlajn. Ka pasur disa incidente të izoluara, të motivuara politikisht, duke përfshirë edhe dëmtimin e shtabeve zgjedhore.
- Korniza ligjore i kufizon donacionet dhe ka caktuar një kufi për shpenzime të fushatës për krye të votuesit të regjistruar. Edhe pse dy raporte të përkohshme financiare do të publikohen para ditës së zgjedhjeve, verifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për fushatën do të bëhet pas mbajtjes së zgjedhjeve.
- Mbulimi i zgjedhjeve nga mediat publike është i rregulluar në mënyrë të rreptë, e poashtu edhe

reklamimi politik në mediat komerciale. Mediat publike duhet të bëjnë mbulim të drejtë mediatik në lajme të garuesve në zgjedhje dhe atyre t'u ofrojnë hapësirë kohore për emetim pa pagesë. Respektimi i kërkesave ligjore nga ana e mediave monitorohet nga Agjencia për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike. Më 21 shtator, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it filloi me monitorimin cilësor dhe sasior të mediave.

- Një numër i shkeljeve zgjedhore janë në kompetencë të KSHZ-së dhe të gjykatave, ndërsa Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit i shqyrton ankesat që kanë të bëjnë me parimin e ndarjes së shtetit nga partia dhe keqpërdorimin e burimeve administrative gjatë fushatës.
- Ligji parasheh që vëzhguesit qytetarë dhe ata ndërkombëtarë të kenë qasje në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Deri tani, katër organizata qytetare janë akredituar për t'i vëzhguar zgjedhjet.

II. HYRJE

Pas ftesës së marrë nga Ministria për Punë të Jashtme, Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR) vendosi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale që do të mbahen më 15 tetor.¹ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, e udhëhequr nga ambasadorja Audrey Glover, përbëhet nga ekipi kryesor 17-anëtarësh që është i vendosur në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë që janë të shpërndarë në tërë vendin. Anëtarët e misionit vijnë nga 22 vende anëtare të OSBE-së. Nga vendet anëtare të OSBE-së është kërkuar që të dërgojnë 300 vëzhgues afatshkurtë për t'i vëzhguar procedurat në ditën e votimit.

III. SFONDI POLITIK

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016, partia Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) nuk arriti marrëveshje me partnerin e saj tradicional të koalicionit, Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI).² Përkundrazi, BDI-ja dhe partitë e tjera të shqiptarëve etnikë u rreshtuan me Lidhjen Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM), mirëpo kryetari i shtetit nuk ua dha atyre mandatin për të formuar qeveri. Më 27 prill, pas disa përpjekjeve të pasuksesshme, u zgjodh kryetari i Kuvendit. Ky zhvillim i ngjarjeve shkaktoi konfrontim në Kuvend, që rezultoi me sulm ndaj deputetëve, duke përfshirë një deputet të LSDM-së dhe një të Aleancës për shqiptarët (ASH). Kriza politike u qetësua vetëm pasi kryetari i shtetit ia dha mandatin LSDM-së që të formojë qeveri, e cila u krijua më 31 maj, pas një vonese gjashtëmujore. Kjo rezultoi me shtyrjen e zgjedhjeve lokale.

Në korrik, qeveria paraqiti një plan për trajtimin e problemit me keqpërdorimin e burimeve administrative, presionin mbi nëpunësit publik, mbulimin jo të balancuar mediatik dhe përmirësimin e transparencës së administratës zgjedhore. Aspiratat shumëvjeçare të vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) dhe në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), përqindja e lartë në vazhdimësi e papunësisë dhe niveli i lartë i emigrimit e formojnë sfondin e këtyre zgjedhjeve. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it mendojnë se mënyra se si do të mbahen zgjedhjet lokale mund të ndikojë në proceset e integritetit që janë në zhvillim e sipër, dhe i shohin ato si test për besueshmërinë e qeverisë së re. Momentalisht, 55 nga gjithsej 80 komuna udhëhiqen nga VMRO-DPMNE-ja, ndërsa LSDM-ja ka 4 nga 81 kryetarët e komunave me përkatësi partiake.

¹ Shih [raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë](#).

² VMRO-DPMNE-ja i ka fituar zgjedhjet parlamentare në vitet 2006, 2008, 2011 dhe 2014, dhe ka udhëhequr me qeverinë deri në maj të vitit 2017.

IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Kushtetuta e ndryshuar e vitit 1991 përcakton një diapazon të gjerë të të drejtave dhe lirive fundamentale. Zgjedhjet lokale kryesisht janë të rregulluara me Kushtetutë dhe me Kodin zgjedhor.³ Rregullativat e miratuara nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) e plotësojnë Kodin zgjedhor; ato nuk duhet të jenë në kundërshtim me ligjin, mirëpo nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.

Siç theksohet në Mendimin e përbashkët të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës të vitit 2016 për Kodin Zgjedhor, korniza ligjore ofron një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, në qoftë se implementohet ashtu siç duhet.⁴ Megjithatë, mbeten disa zbrazëtira dhe paqartësi, duke i përfshirë edhe disa që janë theksuar në rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it.

Kodi Zgjedhor është miratuar në vitin 2006 dhe që atëherë është ndryshuar në masë të konsiderueshme, më në fund në vitin 2016. Poashtu, në vitin 2017, u futën edhe disa ndryshime kyçe: u ndryshua periudha e mbajtjes së zgjedhjeve lokale prej majit në tetor, Gjykata Kushtetuese i anuloi disa dispozita që kishin për qëllim ruajtjen e parimit të ndarjes së shtetit nga partia, dhe Kuvendi u autorizua që ta ndryshojë përbërjen e KSHZ-së që ta pasqyrojë përbërjen aktuale të Kuvendit.

Zgjedhjet lokale mbahen çdo katër vjet për t'i zgjedhur kryetarët e komunave dhe këshillat komunalë në 80 komuna dhe në Qytetin e Shkupit. Këshilltarët zgjidhen me përfaqësim proporcional nëpërmjet listave të mbyllura me kandidatë. Vendet e këshilltarëve ndahen sipas formulës së Dontit (d'Hondt). Kryetarët e komunave zgjidhen sipas sistemit të shumicës në dy rrethe zgjedhore. Në qoftë se asnjë kandidat nuk ka fituar më shumë se 50 për qind të votave të hedhura në rrethin e parë, balotazhi do të mbahet më 29 tetor. Për rrethin e parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, nevojitet pjesëmarrje e një të tretës së numrit të votuesve; në të kundërtën, zgjedhjet përsëriten në komunën përkatëse. Për balotazhin nuk ka ndonjë kusht për përqindje të caktuar të pjesëmarrjes.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet lokale administrohen nga administrata zgjedhore në tre nivele që përbëhet nga KSHZ-ja, 80 Komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni zgjedhor për Qytetin e Shkupit, dhe 3,480 Këshilla zgjedhorë (KZ). Kërkesat për balancin etnik dhe gjinor në administratën zgjedhore janë caktuar në Kodin Zgjedhor.⁵

KSHZ-ja përbëhet nga nëntë anëtarë, tre nga të cilët janë gra.⁶ Sipas ligjit, tre anëtarë të KSHZ-së nuk kanë përkatësi partiake, dhe zgjidhen nëpërmjet konkursit të hapur. Gjashtë anëtarët e tjerë e pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.⁷ Mandati pesëvjeçar i anëtarëve jopartiakë është i mbrojtur, ndërsa të emëruarit partiakë, pas ndryshimeve të vitit 2017 në KZ, duhet të ndërrohen që përbërja e

³ Në ligjet e tjera relevante bëjnë pjesë Ligji për partitë politike, Ligji për financimin e partive politike, Kodi Penal, Ligji për tubimet publike, Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për kontestet administrative, dhe ligjet që kanë të bëjnë me mediat.

⁴ [Mendimi i përbashkët](#) i vitit 2016 i OSBE/ODIHR-it dhe i Komisionit të Venedikut për Kodin zgjedhor poashtu konstaton se shumë rekomandime të mëparshme janë përmbushur, megjithatë, do të ishte e dobishme të bëhet një rishqyrtim i plotë i KZ-së për ta harmonizuar atë me ligjet e tjera relevante.

⁵ Asnjë gjini nuk duhet të jetë më pak se 30 për qind e përfaqësuar në ndonjë komision zgjedhor; në komunat ku një pakicë etnike përbën më shumë se 20 përqind të popullatës së saj, duhet të zbatohet parimi për përfaqësim adekuat dhe të drejtë.

⁶ KSHZ-ja është e mbështetur nga 34 zyra rajonale dhe nga sekretariati që përbëhet nga nëpunës profesionalë shtetërorë.

⁷ VMRO-DPMNE dhe LSDM kanë nga dy anëtarë secila, meqë kanë numrin më të madh të deputetëve në parlament, të pasuara nga BDI dhe BESA me nga një anëtar.

KSHZ-së të jetë në përputhje me përbërjen aktuale të Kuvendit. Në përputhje me këtë, më 22 shtator, anëtari i Lëvizjes BESA e zëvendësoi anëtarin e Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH).⁸ Ndaj një anëtari të KSHZ-së është ngritur padi për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013.

KZK-të përbëhen nga pesë anëtarë, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve shtetërorë në nivel komunal. KZ-të përbëhen nga dy anëtarë të emëruar politikisht dhe tre anëtarë jopartiakë. Përzgjedhja dhe emërimi i KZ-ve akoma nuk ka përfunduar për shumë arsye, njëra nga të cilat është edhe e drejta e atyre që janë zgjedhur ta refuzojnë detyrën.⁹ Trembëdhjetë KZK nuk e plotësojnë kushtin për përfaqësim gjinor.¹⁰

Pushtetet lokale janë përgjegjëse për financimin e zgjedhjeve. Komunat, llogaritë e të cilave janë të bllokuara me vendim gjyqësor për shkak të borxheve të papaguara, do të pranojnë fonde nga buxheti shtetëror. Ministria për Financa tashmë ka ndarë 30 milionë denarë për 17 komuna të tilla.¹¹ Disa KZK e kanë njoftuar MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se edhe përkundër financimit, ato kanë mungesë të hapësirave dhe të materialit.¹²

Sipas ligjit, nga administrata zgjedhore kërkohet që punën e saj ta bëjë publike dhe KSHZ-ja duhet t'i publikojë procesverbalet e mbledhjeve të saj në afat prej 48 orësh nga miratimi i tyre. Edhe pse mbledhjet e KSHZ-së janë të hapura për vëzhguesit dhe mediat, disa vendime deri tani janë marrë në mbledhje të mbyllura dhe vëzhguesit nuk janë informuar paraprakisht.¹³ Poashtu, disa rregulla, vendime dhe udhëzime nuk janë publikuar onlajn. KZK-të nuk janë të obliguara që t'i publikojnë procesverbalet e tyre, mirëpo disa prej tyre e bëjnë këtë në mënyrë vullnetare.

Nga korriku deri në shtator, KSHZ-ja, në bashkëpunim me shoqërinë civile, vlerësoi mundësinë e qasjes në vendvotime për personat me pengesa, gjë e cila tani mund të kontrollohet onlajn. KSHZ-ja planifikon të ofrojë shabllon me alfabet të Brejtit për çdo vendvotim. KSHZ-ja planifikon të realizojë një fushatë për edukim të votuesve dhe për informim, mirëpo akoma nuk ka filluar.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është marrë kjo e drejtë ligjore me vendim gjyqësor. Poashtu, vetëm personat me adresë të paraqitur dhe me letërnjoftim të vlefshëm ose me pasaportë biometrike janë përfshirë në regjistrin e votuesve.

KSHZ-ja e mirëmban regjistrin e votuesve në bazë të të dhënave të nxjerra nga regjistri qytetar dhe ai i popullatës. Ajo e përditëson regjistrin e votuesve katër herë në vit, në bazë të të dhënave që i ofrojnë institucionet e ndryshme shtetërore.¹⁴ Një ditë pasi të shpallen zgjedhjet, bëhet edhe një përditësim

⁸ Mandati i anëtarit të KSHZ-së duhet të përfundojë në vitin 2020; ankesa e tij për shkarkimin që u parashtrua në Gjykatën Administrative dhe në Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit u refuzua.

⁹ Për shembull, KZK-ja në Koçanë duhet të ndërrojë 40 anëtarë të KZ-ve. Disa probleme u raportuan edhe në KZK-të në Manastir, Debarcë, Kërçovë, Kumanovë, Mogillë, Ohër, Strugë, Strumicë, Vevçan dhe Vinicë.

¹⁰ Shtatë KZK kanë më pak se 30 për qind anëtare gra, ndërsa 6 KZK kanë më pak se 30 për qind anëtarë burra.

¹¹ Shumë ekuivalente me 488,000 euro.

¹² Për shembull, KZK-ja e Haraçinës ka mungesë të pajisjeve; KZK-ja e Gazi Babës nuk ka hapësirë përkatëse për zyrë.

¹³ Procesverbali i fundit i KSHZ-së në ueb-faqen e saj është nga data 6 shtator.

¹⁴ Ministria për Punë të Brendshme e informon KSHZ-në për ndryshimet e vendbabeve dhe regjistrin e dokumenteve për identifikim. Gjykatat themelore ofrojnë të dhëna të përditësuara për personat të cilëve u janë marrë të drejtat ligjore.

plotësues. KSHZ-ja ka të drejtë të bëjë inspektime të drejtpërdrejta të rastësishme për verifikim të saktësisë.¹⁵ Për këto zgjedhje, KSHZ-ja nuk ka bërë verifikim gjithëpërfshirës të regjistrit të votuesve.

Këqyrja publike e listave zgjedhore për zgjedhjet lokale u bë prej datës 21 gusht deri më 9 shtator. Gjatë kësaj periudhe, mbi 220,000 votues i kontrolluan të dhënat e tyre dhe vetëm 237 persona kërkuan të bëhen korrigjime.¹⁶ Si rezultat i numrit të vogël të ndryshimeve, bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën besim të shtuar në saktësinë e regjistrit të votuesve, ndërsa disa të tjerë vazhduan të shprehin shqetësim. Më 16 shtator, dy ditë pas afatit të fundit ligjor, partitë kanë pranuar kopje të listave. Pas verifikimit, pesë parti kërkuan shtim ose fshirje të gjithsej 49 votuesve. Përderisa kërkesat për shtim në listë u pranuan, ato për fshirje u refuzuan nga KSHZ-ja, për shkak se këto ndryshime janë në kompetencë të Ministrisë për Punë të Brendshme. Më 25 shtator, një ditë pas afatit të fundit, KSHZ-ja i miratoi listat përfundimtare, ku gjenden 1,814,644 votues, duke i përfshirë edhe 1,882 votues në institucionet ndëshkimore.

Kodi Zgjedhor nuk lejon që votuesi ta ndryshojë vendvotimin, prandaj është përgatitur një dispozitë speciale për anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe për policët në detyrë në ditën e zgjedhjeve, me të cilën atyre u mundësohet të votojnë. Votuesit në shtëpi, të cilët do të bëjnë kërkesë te KZK-ja deri më 8 tetor, do të kenë mundësi të votojnë në kutinë mobile për votim më 14 tetor.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo votues me të drejtë vote që banon në komunën ku ai/ajo dëshiron të garojë mund të kandidojë në zgjedhje, përveç atyre që janë në burg ose atyre që janë në pritje të vuajtjes së dënimit me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj. Partitë, koalicionet dhe grupet e votuesve kanë të drejtë të emërojnë kandidatë për këto zgjedhje. Këta të fundit emërimin e tyre duhet ta mbështesin me nënshkrime prej 0.2 deri në 4 për qind të votuesve me të drejtë vote që banojnë në komunën përkatëse. Nënshkrimet duhet të mblidhen në prani të përfaqësuesit të KSHZ-së në zyrat rajonale të KSHZ-së. Një votues mund të nënshkruajë për të mbështetur më tepër se një listë.

Regjistrimi i kandidatëve përfundoi më 14 shtator, dhe rezultoi me 19 parti dhe koalicione, si dhe 65 grupe të votuesve, të cilat dorëzuan gjithsej 369 lista kandidatësh. Për kryetarë të komunave do të garojnë 258 kandidatë, 20 nga të cilët janë të pavarur.¹⁷ Dy subjekte të ndryshme politike, një parti dhe një koalicion, me emrin e njëjtë Aleanca për shqiptarët, do të garojnë kundër njëra tjetrës. Ankesa e koalicionit për këtë çështje u refuzua.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka njohuri për pesë refuzime të listave të kandidatëve, për të cilat u parashtruan ankesa deri te Gjykata Administrative, e cila i refuzoi ato (katër në sesione të mbyllura). Tre nga këto lista u çregjistruan nga KZK-të për shkak se nuk kishin hapur llogari të veçantë bankare brenda afatit ligjor.

Për ta përmirësuar barazinë gjinore, KZ-ja kërkon që në listat e kandidatëve të përfshihen jo më pak se 40 për qind e gjinisë më pak të përfaqësuar. Nga 258 kandidatët për kryetarë të komunave, 16 janë gra; 52 nga 369 listat me kandidatë udhëhiqen nga gratë. Më 17 shtator, pas përfundimit të afatit për emërim, KSHZ-ja e ndryshoi rregullën, duke sqaruar se si duhet të zbatohet kuota gjinore.

¹⁵ Sipas KSHZ-së, gjithsej 7,007 njerëz që nuk kanë adresë të paraqitur dhe dikur rreth 600 njerëz me “adresë të panjohur” nuk gjenden në listat zgjedhore.

¹⁶ Gjithsej 203,191 persona i kanë kontrolluar të dhënat e tyre onlajn dhe 21,594 në zyrat rajonale të KSHZ-së. Ka pasur 133 kërkesa për korrigjim të të dhënave, 65 për shtim në listë, 22 për heqje për shkak të vdekjes dhe 10 kërkesa të natyrave të tjera.

¹⁷ Në kundërshtim me KZ-në, KSHZ-ja organizoi dy shorte për renditjen në fletëvotim; njërin për partitë dhe koalicionet, ndërsa tjetrin për grupet e votuesve. Këta të fundit u vendosën në fund të listës.

VIII. AMBIENTI I FUSHATËS

Fushata zyrtare filloi më 25 shtator dhe do të përfundojë në mesnatë të datës 13 tetor.¹⁸ Në KZ fushata është e rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në përgjithësi ofron kushte për terren të barabartë për garim. Aq më tepër, ligji ka për qëllim t'i mbrojë votuesit nga presioni i panevojshëm dhe kufizimet e ndryshme kanë për qëllim ta mbështesin ndarjen e shtetit nga partia, si dhe ta parandalojnë keqpërdorimin e burimeve administrative. Pushtetet lokale luajnë rol të rëndësishëm në fushatë duke ndarë hapësirë për reklamim në hapësira të jashtme.

Më 5 shtator, qeveria e miratoi Deklaratën për zgjedhjet e lira dhe të drejta, duke i bërë thirrje publikut dhe zyrtarëve shtetërorë që të përmbahen nga aktivitetet malverzuese dhe ta respektojnë të drejtën e votuesve që të zgjedhin në mënyrë të lirë. Më 19 shtator, qeveria miratoi disa ligje për çështjet financiare dhe shoqërore. Më 24 shtator në KSHZ dhe nëpër KZK-të, kandidatët për kryetarë të komunave nënshkruan kodin e sjelljes duke premtuar se do ta respektojnë ligjin.

Ambienti para fushatës zgjedhore ishte i qetë me incidente të pakta të izoluar.¹⁹ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka vërejtur raste të zhvillimit të parakohshëm të fushatës nga disa parti.²⁰ Një numër i palëve të interesuara të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësim për blerjen potenciale të votave, frikësimin dhe përdorimin e burimeve qeveritare për zhvillimin e fushatës. Para pak kohësh, u ngritën akuza kundër dy kryetarëve aktualë të komunave për keqpërdorim të detyrës zyrtare, duke përfshirë edhe shkelje që kanë të bëjnë me zgjedhjet.²¹

Fushata filloi me tubime festive, ku liderët e partive i prezantuan kandidatët e tyre, i zbuluan sloganet e fushatës dhe i paraqitën platformat e politikave të tyre. Edhe pse partitë bëjnë fushatë për çështjet komunale, platformat përfshijnë edhe tema të nivelit shtetëror. Nga 25 shtatori, nëpër qendrat urbane u paraqitën bilborde të mëdha, në pjesën më të madhe të cilave ishin të paraqitur kandidatët për kryetarë të komunave. Në disa qytete, partitë hapën zyra të përkohshme. Garuesit planifikojnë të blejnë hapësirë për reklamim në televizione dhe në mediat e shtypura, si dhe ta rrisin bazën që i mbështet ata nëpërmjet rrjeteve sociale.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Fushatat financohen nga donacionet dhe anëtarësia partiake. Donacionet publike, të huaja dhe ato anonime janë të ndaluara. Donacionet nuk duhet ta kalojnë vlerën prej 3.000 eurosh (për individë) dhe 30.000 euro (për subjektet juridike), duke i përfshirë edhe kontributet në të mira materiale. Shpenzimet kompensohen pjesërisht nga administrata lokale për listat që kanë marrë së paku 1.5 për qind të të gjitha votave të hedhura në një komunë (0.24 euro për një votë).²² Të gjitha transaksionet e fushatës duhet të realizohen nëpërmjet llogarisë së veçantë bankare për këtë qëllim.

Limiti për shpenzim në fushatë është 1.8 euro për kokë të votuesve të regjistruar në komunë, për çdo rreth zgjedhor. Enti shtetëror për revizion (ESHR) bën kontroll dhe i shqyrton ankesat në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore. Ai duhet të pranojë dhe të publikojë dy raporte të përkohshme për financimin e fushatës nga çdo dorëzues i listës, mirëpo nuk është i detyruar të bëjë revizion të tyre.²³ Revizion u bëhet vetëm raporteve përfundimtare, të cilat garuesit duhet t'i dorëzojnë në afat prej katër muajsh pas zgjedhjeve. ESHR-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se jo domosdoshmërisht bën

¹⁸ Për zhvillimin e fushatës para fillimit të saj zyrtar është paraparë gjobë e lartë.

¹⁹ Më 24 shtator u vandalizua shtabi i VMRO-DPMNE-së në Kisella Vodë, ndërsa më 29 shtator shtabi në Kavadar; si dhe u dëmtua zyra e LSDM-së në Butel më 27 shtator dhe më 24 shtator në Aerodrom,

²⁰ Më 24 shtator, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i vëzhgoi tubimet në Shkup (BDI), në Strugë (ASH), në Veles (VMRO-DPNE dhe LSDM) dhe në Tetovë (BESA).

²¹ Padi janë ngritur kundër kryetarit të Shtipi më 21 shtator dhe kundër kryetarit të Novo Sellos më 26 shtator.

²² Shumat në KZ janë shënuar në euro. 1 euro është e barabartë me 61. denarë

²³ Raportet duhet të publikohen në ueb-faqet e ESHR-së, KSHZ-së, KSHPK-së dhe të subjekteve politike.

revizion të të gjitha raporteve të pranuar. Ndëshkimet për shkelje në këtë aspekt përfshijnë anulimin e kompensimeve dhe dënime të rrepta penale varësisht nga shkelja.

Më 1 shtator, Ministria e Financave lëshoi një shabllon të ri të dokumentit për raportim, ku kërkohen informata gjithëpërfshirëse për të gjithë donatorët dhe, në përputhje me rekomandimin e mëparshëm të OSBE/ODIHR-it, ndarje të detajuar të donacioneve dhe të shpenzimeve. Shablloni momental nuk ka ndarje të shpenzimeve sipas komunave.

Degët rajonale të partive e informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se fushatat kryesisht do të financohen nga mjetet që do të mbledhen në nivel lokal; partitë parlamentare parashohin edhe ndarjen nga qendra të mjeteve dhe të mallrave për fushatë. Partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur iu ankuan MVZ-së së OSBE/ODIHR-it për mungesë të financimit.

X. MEDIAT

Një numër i madh i mediave, të ndara në bazë politike, veprojnë në një treg të vogël për reklamim. Televizioni është burimi kryesor i informimit; qarkullimi i gazetave është mjaft i vogël, ndërsa depërtimi gjithnjë e më i madh i internetit ka mundësuar zhvillimin e dukshëm të ueb-faqeve me lajme. Më 19 shtator, Kuvendi e hoqi taksën për radiodifuzion për financimin e transmetuesit publik Radio Televizionit të Maqedonisë (RTM), Agjencisë për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (ASHAM) dhe Radiodifuzionit të Maqedonisë (RDM). Nga 1 tetori, këto institucione do të financohen vetëm nga buxheti shtetëror. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësim se kufizimet e tilla për financim mund ta vështirësojnë punën e ASHAM-it dhe ta dobësojnë edhe më shumë RTM-në si transmetues publik, për shkak të ndërhyrjes së mundshme politike.²⁴

Kushtetuta e garanton lirinë e të shprehurit dhe e ndalon censurimin. Kodi Zgjedhor parasheh që të gjitha mediat t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, duke e bërë këtë edhe në ueb-faqet e tyre. Nga RTM-ja kërkohet që garuesve politikë t'u sigurojë hapësirë kohore për emetim pa pagesë në periudhën me shikim më të madh.²⁵ Nuk do të ketë short për ndarjen e këtyre hapësirave për emetim; renditja do të përcaktohet në bazë të kërkesave të kandidatëve. Mbulimi i zgjedhjeve në lajmet e RTM-së është i rregulluar në mënyrë të rreptë, e poashtu edhe reklamimi i paguar në mediat komerciale.²⁶

Respektimi i ligjeve nga ana e mediave monitorohet nga ASHAM-i. ASHAM-i mund të shqiptojë sanksione në rast të shkeljeve dhe mund ta përcjellë çështjen në gjykatën kompetente. Që nga 7 gushti, ASHAM-i ka bërë monitorim sistematik të mediave dhe rezultatet i publikon në ueb-faqen e tij çdo 10 ditë. Deri tani, ASHAM-i ka vërejtur se mediat kryesore kanë kryer mbulim më të balancuar se sa në zgjedhjet e mëparshme.

Disa media nacionale organizojnë në mënyrë aktive debate ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunave në komunat e tyre përkatëse. Diskutime të gjalla ndërmjet kandidatëve dhe mbështetësve të tyre zhvillohen në rrjetet sociale. Më 21 shtator, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it filloi me monitorimin

²⁴ TVM-ja, ASHAM-i dhe RDM-ja do të marrin gjithsej 0.5 për qind nga buxheti shtetëror për vitin 2018; 75 për qind e kësaj shume do të jetë e dedikuar për TVM-në. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it besojnë se jo më pak se një për qind janë të nevojshme.

²⁵ Kandidatëve për kryetarë të komunave u takojnë pesë minuta, ndërsa secilit nga kryesuesit e listave të kandidatëve u takojnë nga tre minuta.

²⁶ TVM-ja duhet t'ia kushtojë nga 30 për qind të edicioneve të saj ditore të lajmeve aktiviteteve të fushatës për partinë në pushtet dhe për partinë opozitare dhe 10 për qind për të gjitha partitë joparlamentare së bashku. Reklamata e paguara janë të lejuara vetëm në mediat komerciale; secila nga partitë mund të blejë deri në tetë minuta brenda një ore; ndërsa të tjerët deri në një minutë brenda një ore.

sasior dhe cilësor të mbulimit mediatik të çështjeve që lidhen me zgjedhjet të gjashtë kanaleve kryesore televizive dhe të katër gazetave të përditshme.²⁷

XI. ANKESAT DHE APELIMET

KSHZ-ja, organet e pavarura administrative dhe gjykatat janë përgjegjëse për të gjykuar për rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet.²⁸ Një numër i bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it kanë shprehur shqetësim për mungesën e supozuar të paanshmërisë nga ana e KSHZ-së dhe e gjykatave gjatë shqyrtimit të rasteve të ndjeshme politike.

Partitë mund të ankohen në Gjykatën Administrative ndaj vendimeve të KZK-ve me të cilat refuzohen listat e kandidatëve; mirëpo vendimet dhe veprimet e tjera të KZK-ve nuk i nënshtrohen shqyrtimit nga ana e KSHZ-së apo atij gjyqësor. Votuesit mund t'i parashirojnë ankesat në KSHZ për listat zgjedhore dhe për shkeljen e të drejtës së tyre për të votuar. Subjektet politike mund t'i kundërshtojnë vetëm listat zgjedhore, parregullsitë gjatë votimit dhe numërimit të votave.²⁹ Përderisa vendimet e KSHZ-së për ankesat dhe anulimet e rezultateve shqyrtohen nga ana e Gjykatës Administrative, vendimet dhe veprimet e tjera administrative nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.³⁰

Ankesat për shkeljet e rregullave të fushatës nuk janë në mandatin e KSHZ-së dhe konsiderohen si çështje penale ose civile. Kontestet në lidhje me veprimet e qeverisë dhe të subjekteve publike që i shkelin dispozitat që kanë për qëllim ndarjen e shtetit nga partia dhe parandalimin e shfrytëzimit të burimeve publike për fushatë, janë në kompetencë të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK). KSHPK-ja ka pranuar rreth 15 ankesa kundër subjekteve publike për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së nëpunësve publikë gjatë periudhës zgjedhore.³¹

XII. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Marrëdhëniet ndëretnike luajnë rol në zgjedhje, veçanërisht në nivel lokal. Çështjet që janë me rëndësi për marrëdhëniet ndëretnike, siç është propozim-ligji për përdorimin e gjuhëve, përdoren në fushatë së bashku me çështjet e veçanta lokale. Kandidatët dhe listat tentojnë ta pasqyrojnë përbërjen etnike të komunës. Megjithatë, në disa raste, ata kanë kërkuar të fitojnë vota përtej kufijve etnikë. Në komunat me shumicë etnike shqiptare, disa parti etnike shqiptare që janë pjesë e qeverisë, garojnë kundër njëra tjetrës.³²

Partitë që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike kanë paraqitur kandidatë për kryetarë të komunave vetëm në raste të pakta, atje ku këto grupe etnike janë të koncentruara në një komunë, siç janë turqit etnikë në Qendër Zhupë dhe romët në Shuto Orizare. Në vendet tjera, ato paraqesin listë me kandidatë për këshillat komunalë. Partitë nga bashkësitë më të vogla iu ankuan MVZ-së së OSBE/ODHIR-it se nuk kanë anëtarë të tyre në KSHZ dhe se nuk janë të përfaqësuar sa duhet në administratën zgjedhore lokale.

²⁷ Këtu bëjnë pjesë *TVM-1, TVM-2, Sitel-i, Kanal 5, Telma, Alsat-M*; gazetat *Nova Makedonija, Sloboden Pecat, Veçer dhe Koha*.

²⁸ Ligji parashihet kompetencë për KZK-të që të marrin vendime për ankesat, mirëpo nuk përcakton asnjë lloj të veçantë të ankesave që janë në kompetencë të tyre; KSHZ-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se në praktikë KZK-të nuk do t'i shqyrtojnë ankesat.

²⁹ Më 21 korrik, KSHZ-ja e ndryshoi procedurën për ankesa ku parashihet se ankesat që kanë të bëjnë me ditën e zgjedhjeve nuk do të konsiderohen të vlefshme nëse parregullsia nuk është shënuar në protokollin e vendvotimit, ose nëse nuk është dorëzuar në KZK në afat prej pesë orësh pas plotësimit të protokollit.

³⁰ Përjashtimi i vetëm është se mund të apelohej për vendimet e KSHZ-së që i prekin interesat e pakicave.

³¹ Dy raste janë pranuar; për disa të tjera do të ketë hetime të mëtejshme. Më 15 gusht, KSHPK-ja lëshoi një mendim se shkarkimi i Prokurorit publik do të ishte shkelje e KZ-së; Prokurori publik u shkarkua.

³² Për shembull në Gostivar, ku ministri i shëndetësisë i ASH-së garon kundër kryetarit aktual të komunës nga radhët e BDI-së dhe në Strugë, ku kryetarit komunal nga radhët e ASH-së do t'i kundërvihet kandidati i BDI-së, i cili ka qenë kryetar i mëparshëm i komunës.

XIII. VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parashih që vëzhguesit qytetarë dhe ata ndërkombëtarë të kenë qasje në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Deri tani, KSHZ-ja ka akredituar katër organizata vëzhguese qytetare, të cilat do ta vlerësojnë punën e administratës zgjedhore dhe do të shpërndajnë një numër të konsiderueshëm të vëzhguesve në ditën e zgjedhjeve.³³ Garuesit në zgjedhje poashtu mund të akreditojnë përfaqësues të tyre. Për dallim nga vëzhguesit qytetarë, vëzhguesit partiakë mund të parashtrajnë ankesa në të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

XIV. AKTIVITETET E OSBE/ODIHR-IT

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it filloi me punë më 13 shtator, dhe është takuar me kryetarin e shtetit, kryeministrin, KSHZ-në, agjencitë e tjera shtetërore, si dhe me përfaqësuesit e partive politike, mediave, shoqërisë civile, si dhe Misionit të OSBE-së në Shkup dhe të bashkësisë ndërkombëtare. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka vendosur kontakte me të gjitha palët e përfshira në procesin zgjedhor në të gjitha nivelet. Kongresi i autoriteteve lokale dhe rajonale i Këshillit të Evropës planifikon të dërgojë një delegacion për vëzhgim në ditën e zgjedhjeve.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*

³³ MOST-i planifikon të shpërndajë rreth 3,000 vëzhgues, ndërsa CIVIL-i planifikon të ketë rreth 100 vëzhgues në ditën e zgjedhjeve. Poashtu, Qendra maqedonase për kulturë dhe zhvillim ka vëzhgues të akredituar.